



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 15110/18  
Nr. i fq. / Br. st. 3  
Data: / Datum: 28-03-2018

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c) lidhur me nenin 17, pikat (k, r dhe s) të Ligjit Nr. 03/L-40 mbi Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Rregulloren MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 41, paragrafi 2, pika (c) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe në bazë të propozimit nr. 33/2018, datë 28 mars 2018, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport , merr vendim dhe shpallë:

### THIRRJE PUBLIKE

- **Për financimin e projekteve të personave juridik - OJQ-ve, në vlerë mbi 500 Euro, nga fusha e Kulturë, Rini dhe Sport, bazuar në kriteret më poshtë:**
- 1. Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit (në cilësinë e personave juridikë - OJQ) mbi pesëqind (500) €, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:
  - a. të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizatën joqeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
  - b. të jenë të pajisura me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionit ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
  - c. të kenë të kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
  - d. të mos kenë pranuar mjete tjera nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete, dhe
  - e. të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për subvencionimin e personave juridikë – OJQ:
  - a. kërkesën me shkrim;
  - b. projekt propozimi (maksimumi 2 projekte nga një OJQ dhe maksimumi i kohëzgjatjes së projektit është 12 muaj)
  - c. Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore, i cili duhet të dorëzohet komisionit vlerësues para publikimit të rezultateve përfundimtare.
  - d. deklaratë e nënshkruar se për të njëjtin projekt nuk është pranuar financim i dyfishtë nga burimet tjera
  - e. dorëzimin e raportit për vitin paraprak, në rast të subvencionimit të mëhershëm;
  - f. certifikatën e regjistrimit të OJQ-së;
  - g. certifikatën e numrit fiskal
  - h. arsyetimin e kërkesës;
  - i. dokumentin identifikues të përfaqësuesit ligjor të personit juridik;
  - j. numrin e llogarisë bankare të personit juridik.
3. Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare që ka shpallur thirrje publike për mbështetje financiare në vlerë mbi pesëqind (500) €, themelon Komisionin vlerësues, i përbërë nga anëtarët që kanë përvojë dhe integritet, me mandat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve.
4. Përbërja e komisionit (në rastet e thirrjeve publike për mbështetje financiare), kohëzgjatja dhe mandati i tij caktohet me vendim të Kryetarit të Komunës.
5. Komisioni vlerësues (në rastet e thirrjeve publike për mbështetje financiare), përbëhet nga pesë (5) anëtarë, dhe ka mandat dy (2) vjeçar, si në vijim:
  - a. një (1) përfaqësues nga njësia përkatëse (drejtoria përgjegjëse), në kuadër të të cilit është planifikuar mbështetja financiare;
  - b. dy (2) përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve, të cilët do të zgjidhen përmes një thirrjeje publike, të cilën do ta bëjë ofruesi i mbështetjes financiare;
  - c. dy (2) përfaqësues nga institucioni (Drejtoria për Buxhet dhe Financa) që ofron mbështetje financiare, njëri nga të cilët duhet të jetë nga njësia përkatëse për buxhet dhe financa.

6. Përveç anëtarëve të rregullt të Komisionit vlerësues, Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të parasheh me vendim edhe një (1) anëtar rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevojë anëtarin e Komisionit vlerësues, i cili ka konflikt të interesit.
7. Komisioni vlerësues themelohet gjatë kohës sa thirrja publike është e hapur dhe emrat e anëtarëve të Komisionit vlerësues bëhen publik brenda shtatë (7) ditëve pas themelimit të komisionit.
8. Komisioni vlerësues në mbledhjen e tij të parë miraton rregullat e punës, përmes të cilave do të udhëhiqet puna në komision dhe këto rregulla bëhen publike brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit.
9. Anëtarët e Komisionit vlerësues nuk mund të jenë të emëruarit politik.
10. Me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës do të përcaktohet mënyra dhe shuma e kompensimit për dy (2) anëtarë e Komisionit vlerësues përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm.
11. Palët e pakënaqura me vendimet e komisionit vlerësues mund të i paraqesin ankesat e tyre pranë Komisionit për Ankesa anëtarët e të cilit caktohen me vendim të Kryetarit të Komunës. Në Komisionin e ankesave nuk mund të marrin pjesë anëtarët, të cilët janë pjesë e Komisionit vlerësues dhe të emëruarit politikë. Komisioni i Ankesave përbëhet nga tre (3) anëtarë dhe ka mandat dy (2) vjeçar.
12. Dokumentacioni për aplikim kopje, dorëzohet në zyrën e pranimit në Komunën e Vushtrrisë.
13. Thirrja për konkurrim mbetet e hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në web faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve.
14. Kërkesat e arritura pas afatit nuk do të shqyrtohen, kurse dokumentacioni i pakompletuar do të refuzohet.

Vushtrri 28.03.2018



Drejtori i DKRS

*Atmire*

Atmire CECELIA